

Në bazë të nenit 7, alinea 9 nga Ligji për themelim të Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe 190/19), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural e publikon këtë:

**THIRRJE PUBLIKE nr. 07/2021**  
**për parashtrim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021**

### I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është shpërndarja e mbështetjes financiare për masat në vijim:

Kodi i masës	Emri i masës	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues
Masa 112	Ndihmë për bujqit e ri për fillim të veprimtarisë bujqësore	deri 600.000,00 denarë shpenzime të pranueshme për shfrytëzues individual

### II. SHFRYTËZUES

Të drejtë në shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Kodi i masës
Ekonomitë bujqësore të regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillimin rural	Masa 112

### III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzimeve operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzime tjera të parapara me Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021.

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues për Masën 112 është 600.000,00 denarë. Mjetet ndahen për periudhën e realizimit të plani afarist dhe paguhen në nivel vjetor në më së shumti tre kështe.

- Mbështetja është e kushtëzuar me plotësim të detyrueshëm të aktiviteteve të parapara nga Plani afarist për masën 112.

### IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesat parashtrohen në formë elektronike pas regjistrimit të realizuar në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk)

Një kërkesë mund të parashtrojë vetëm një kërkesë për një masë ose më së shumti 2 kërkesa për masa të ndryshme duke i marrë parasysh edhe masat tjera nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021 ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë së Veriut" nr. 12/21, 31/21, 53/21, 79/21, 92/21, 121/21 dhe 166/21).

- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17 dhe 83/18)

- Rregulloren për kriteret e përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20 dhe 96/21) dhe

- Rregulloren për kushtet plotësuese më të përafërta për mbështetjen e masave për zhvillimin rural, shpenzimet e pranueshme dhe shuma e mbështetjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë individuale ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16, 178/18, 77/19 dhe 214/19).

Kërkesit e mbështetjes financiare është e nevojshme të krijojnë kërkesë elektronike për mbështetjen financiare me të dhëna për lokacionin e investimit, të dhënat për investimin dhe në mënyrë elektronike të bashkëngjitin dokumentet (ofertë/profaturë për investimin e propozuar dhe plan afarist të përpiluar në pajtim me formularin e paraparë "Plani afarist për masën 112").

Kërkesit që i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 112 radhiten me vlerësim të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masat për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr. 96/21).

- Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të radhiten sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës elektronike në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk)

- Kërkesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para lidhjes së Marrëveshjes për ko-financim me Agjencinë.

- Kërkesat të cilat nuk janë të parashtruara në mënyrë elektronike në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk) nuk do të shqyrtohen.

- Vërejtje: Kërkesi të mos ketë të shfrytëzuar ndihmë nga masat 112 Ndihmë për bujq të ri për fillim të veprimtarisë bujqësore dhe 113 Ndihmë për nxitjen e prodhimit bujqësor.

### V. TËRHEQJE TË FORMULARËVE DHE UDHËZIME

Udhëzimi për regjistrim të kërkesve në sistemin për parashtrim elektronik të Kërkesës mund të merret në faqen fillestare në [e-bارانje.ipardpa.gov.mk](http://e-bارانje.ipardpa.gov.mk). Udhëzimi për shfrytëzues për masë individuale mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masën. Udhëzimi për shfrytëzues mund të tërhiqet në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk) ose të merret direkt në Agjencinë çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 16:00 në adresën:

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,**  
**bul. "3-ta Makedonska brigada" nr. 20**  
**(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)**  
**1000 Shkup**

### VI. MËNYRA E PARASHTRIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesa e plotësuar elektronike për mbështetje financiare është e nevojshme të shkarkohet, printohet dhe nënshkruhet dhe së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruet të parashtrohet deri te Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural në zarf të mbyllur në të cilin në anën e përparme në këndin e lartë të majtë qëndron **Kërkesë për mbështetje financiare dhe Numri arkivues i Kërkesës (0721-11216-XXXX/1)**. Kërkesa mund të parashtrohet përmes postës së rekomanduar ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritje të vonuar ose të pakompletuar në sportel ose hapje të parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për parashtrim të kërkesave është **29.08.2021**.

Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen.

Informata më të hollësishme në kontakt tel: (02) 3097-460 ose  
në e-mail adresën [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)  
dhe ueb-faqen [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

Kontakt:

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,**  
**Spektori për miratimin e projekteve.**

Telefoni: 02 3097 - 460, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri 16:00.

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)

